

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ONE ASSISTA" SHPK

Sot me daten 21/02/2023 (dymijë e njëzet e tre), ne ortaket themelues :

- I Z. Mifail Shaqiri, shtetas Kosovar, i datëlindjes 09 Nëntor 1980, lindur në Gjilan ,Kosovë dhe banues në Zvicër, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr.X7840457.
- Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " ONE ASSISTA" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " ONE ASSISTA" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Lagjja nr 15, rruga Aleksander Goga, zona kadastrale 8517, truall me nr. pasurie 153/415,Durres.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e : eksport ,import, tregti,transport brenda dhe jashte vendit, dhënie me qera të automjeteve të tonazheve të ndryshme,agjensi imobiliare, blerje, shitje, dhënie me qera , ndërmjetësim për shitje dhe blerje të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të llojeve të ndryshme, ndërtesa, apartamente, toka truall dhe arë, pyje,njësi tregtare,garazhde.Ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mardhënies me publikun, marketing dixhital nëpërmjet ofrimit të dizenjimit dhe menaxhimit të faqeve të rrjeteve sociale për qëllime marketing. Shërbime marketing online. Krijim, menaxhim, dhe shitje të faqeve website. Çdo gjë që i shërben aktivitetit dhe cdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË



Kapitali themeltar i shoqërisë " ONE ASSISTA" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) secila.

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

1. MIFAIL SHAQIRI zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator të shoqërisë do të jenë

- 1- **Z. MIFAIL SHAQIRI**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUJDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durres për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"ONE ASSISTA" SH.P.K
MIFAIL SHAQIRI

Mifail Shaqiri 

